



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Donjeta Elezi, në çështjen juridike të paditësit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. [REDACTED] të cilin e përfaqëson av. [REDACTED] me autorizim, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj Rr. " [REDACTED]", për mos përbushjen e kontratës së qirasë, vlera e kontestit 2.130,34 €, pas seancës publike të mbajtur më 03.09.2015, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij dhe në mungesë të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tërsi si e bazuar kërkësë padia e paditësit, [REDACTED]

DETYROHET i padituri [REDACTED], që paditësit t'ia paguajë shumën prej 2.130,34€, në emër të borxhit të energjisë elektrike të cilin e ka krijuar me rastin e shpenzimit të energjisë elektrike, sa ishte shfrytëzues i lokalit afarist për periudhën nga dt.01.04.2004 e gjer me dt.31.03.2006, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 580€, (pesëqind e tetëdhjetë) të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Gjkata sipas udhëzimeve nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës me aktvendimin CA.nr.3376/2013 dt.16.02.2015 me të cilin e ka prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.9/2010 dt.21.06.2013.

Gjkata pas pranimit të aktvendimit nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës të njëjtin e ka analizuar dhe e ka caktuar seancën e shqyrimit me datën 03.09.2015,

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij në fjalën përfundimtare ka deklaruar duke marr parasysh udhëzimin e Gjykatës së Apelit lidhur me periudhën kohore siç është e rregulluar me kontratën për qiranë ka bërë precizimin e kërkësë padisë në periudhën kohore dhe atë nga data 01.04.2004 deri më dt.31.03.2006, e cila periudhë parashihet me

kontratën e qirasë në nenin 3 të saj si dhe shumën e kërkesë padisë në shumë prej 2.130,34€.

Ka kerkuar nga ana e gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e precizuar si dhe ka kerkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri në seancën e datës 03.09.2015, ka munguar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt siç shihet nga flet kthesa e Gjykatës ku ftesën, e ka pranuar me datë 07.08.2015, shtyrjen nuk e ka kerkuar dhe mungesën nuk e ka arsyetur, andaj Gjykata seancën e ka mbajtur në mungesë të paditurit konform nenit 423 par. 4 të LPK-së.

I padituri edhe pse nuk ka prezantuar por në ankesën e tij të paraqitur kundër aktgjykimit të kësaj gjykata ka thënë vërejtjet e tij e të cilat vërejtje Gjykata e Apelit me aktvendimin e saj e prishur aktgjykimin e kësaj gjykate.

Gjykata në këtë çështje juridike bëri administrimin e provave duke bërë leximin e tyre: Lexohet procesverbali i dt.21.06.2013, në të cilin është bërë administrimi i provave, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.9/10 dhe aktgjykimi i Gjykatës së apelit të Kosovës CA.nr.3376/13 dt.16.02.2015.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara një nga një dhe të gjitha s'bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së gjeti se kërkesë padia e paditësit është e bazuar ashtu siç është aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga provat e administruara u vërtetua se i padituri i ka borxh paditësit shumën prej 2.130,34€, siq shihet në transaksionin e konsumatorit për periudhën e precizuar nga ana e të autorizuarit të paditësit, e cila periudhë i përket kohës sa ka qenë druar i padituri me qera në lokalini e paditësit.

Se i padituri ka qenë shfrytëzuas i këtij lokalit kjo vërtetohet me kontratën e qirasë të lidhur në mes paditësit dhe të paditurit.

Se palët ndërgjyqëse kanë lidhur kontratë me qiranë dhe në të cilën kontratë në nenin 6 (gjashtë), janë përcaktuar detyrimet e qiramarrësit-të paditurin siq parashihet me

nenin 26 të LMD-së të cilat detyrime nuk i ka kryer duke përjashtuar shumën prej 125€, të cilën paditësi e ka bërë në emër të energjisë elektrike me datën 19.09.2005,

Andaj edhe nga kjo kontratë palët ndërgjyqëse kanë krijuar të drejtat dhe detyrime në kuptim të nenit 148 të LMD-së, i cili fakt vërtetohet nga kontrata e qirasë dhe transaksi i konsumatorit me shifër DFE 9012769 ku shihet se i padituri nuk i ka kryer obligimet e energjisë elektrike ashtu siq ka qenë i obliguar me kontratën e qirasë me nenin 6 (gjashtë) të saj.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet të paguaj 580 € dhe atë për tri përfaqësimë të avokatit në seanca, në shumë prej 405€, kurse për dy seanca-përfaqësim të cilat nuk janë mbajtur shumën prej 135€, dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej (20€) dhe aktgjykim prej 20€, e cila është llogaritur në bazë të shumës së aprovuar të kërkesepadisë, kurse ka refuzuar pjesën tjeter si të pabazuar.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
C.nr.127/15 më dt.03.09.2015




KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSENZA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROSEVAC

Më
Dana



Ac.nr. 4382/15

